

**VENDIM**  
**Nr.107, datë 25.2.2005**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.596, DATË 10.9.2004 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL Durrës**  
**DHE PËR RIORGANIZIMIN E TIJ” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.390,**  
**DATE 15.8.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN OBJEKTEVE TË**  
**RËNDËSISË SË VEÇANTË ME FORCAT E POLICISË SË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në statutin e Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr.596, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave, pas nenit 18, shtohet neni 19, me përmbajtje sipas anekseve 1, 1/1 dhe 1/2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave, emërtimi me nr.2 “Porti Detar Durrës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**ANEKSI 1**

**Neni 19**

**Shërbimi i sigurisë në anije dhe në port**

1. Forca e sigurisë në anijet dhe në portin e Durrësit (FSAP), në varësi të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës, organizohet sipas strukturës, e cila i bashkëlidhet këtij statuti, aneksi 1/1.

Autoriteti Portual Durrës, në varësi të rritjes së vëllimit të punës, ka të drejtë të rrisë ose të pakësojë numrin e punonjësve të FSAP-së, por pa ndryshuar strukturën.

2. FSAP-ja e zhvillon veprimtarinë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve, të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), me konventën SOLAS, 74, të ndryshuar me ligjin nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Kjo forcë sigurie ka për detyrë:

a) Mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, të objekteve dhe vlerave të portit.

b) Krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për Autoritetin Portual Durrës dhe operatorët e ndryshëm, që veprojnë në këtë port, për një punë 24-orëshe (me tre turne).

3. Drejtori i FSAP-së, në Durrës, është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës dhe përgjigjet para tij për të gjithë veprimtarinë e sigurisë në port dhe në anijet e ankoruara, në lëvizje nga/dhe në drejtim të portit, në radë, si dhe vepron në përputhje me udhëzimet e drejtorit ekzekutiv.

4. Kriteret profesionale për përzgjedhjen (rekurtimin) e anëtarëve të FSAP-së përcaktohet nga Autoriteti Portual Durrës dhe miratohen nga Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit.

5. FSAP-ja është pajisur me armatimin dhe mjetet e nevojshme, për të siguruar mbrojtjen e portit dhe të anijeve nga çdo sulm i mundshëm, terrorist a keqbërës, apo nga hyrja, në mënyrë të kundërligjshme, e shtetasve dhe e mjeteve në zonën, që ka objekt kontrolli. Pajisjet, mjetet dhe armatimi i lejuar përcaktohen në aneksin 1/2, që i bashkëlidhet statutit.

6. FSAP-ja kur, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, vëren kryerjen e një vepre penale, siguron vendin e ngjarjes, provat materiale, ndalon autorët dhe njofton strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit e prokurorinë dhe bashkëvepron me ta për vazhdimin e procedimit penal.

Gjithashtu, FSAP-ja kur vëren shkelje apo shmangie nga detyrimet doganore, i raporton menjëherë degës së doganave, Durrës.

7. Komiteti i Sigurisë në anijet dhe në portin e Durrësit është organ kolegjal dhe kanë përbërje:


- Drejtorin Ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës kryetar;
- Një përfaqësues të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë anëtar;
- Një përfaqësues të Drejtorisë së Transportit Detar anëtar;
- Një përfaqësues të këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës anëtar;
- Kapitenin e Përgjithshëm të porteve anëtar;
- Një përfaqësues të Ministrisë së Rendit Publik anëtar;
- Një përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes anëtar;
- Një përfaqësues të Ministrisë së Financave anëtar.

8. Ky Komitet vlerëson projektplanet e sigurisë dhe bashkërendon punën me palët operuese në port, për zbatimin e këtyre planeve. Komiteti i Sigurisë mbledhet një herë në tre muaj, por, me kërkesë të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë apo të Autoritetit Portual Durrës, mund të mbledhet edhe më shpesh.

9. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, në përputhje me ligjin nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, miraton rregulloren e brendshme për funksionimin e FSAP-së.

## FORCA E SIGURIMIT E PORTIT TE DURRESIT

Aneksi 1/1



### SHENIME:

- Drejtori i Forces se Sigurimit te Portit i jep llogari drejtperdrejt Drejtorit te Autoritetit Portual.
- Shefat e turneve mund te jene neninspektore, inspektore ose kryeinspektore.
- Nje agjent nga secili turn do te emerohet zevendes i shefit te turnit.

## PAJISJE E FORCËS SË SIGURISË

### Përshkrim

#### ARMË

Pistoleta

Shkop zgjatues dhe mbajtës

#### TRANSPORT

4 mjete foristradë

Mjet lundrues patrullues

#### NDËRLIDHJE

Radio stacionare VHF

Radio dore VHF

Karikues baterish

Bateri rezervë

#### UNIFORMA

Verore/dimërore++